



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 231/4 Prot

Tiranë, më 06.07.2022

V E N D I M

Nr.92, datë 06.07.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, në Bashkinë Vau Dejë, ku përfshihet dhe transferimi i përhershëm i nëpunëses *** , për shkak të shkurtimit të vendit të punës.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me transferimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialiste në QKB”, Drejtoria Ekonomike, në Bashkinë Vau Dejë, (Kategorinë e pagës IV-a).

VËREJ SE:

Nëpunësja civile ***** , ka qenë me detyrë prej disa kohësh “Specialiste Finance në Sektorin e Fuqizimit Ekonomik”, në Drejtorinë e Mbrojtjes, Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale, në Bashkinë Vau Dejës, Kategori e pagës III-b. Në vijim, me vendim të Njesisë Përgjegjëse të Bashkisë Vau Dejës (Akti nr. 68, datë 31.12.2021) bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, kjo nëpunëse është transferuar në pozicionin “Specialiste në QKB”, Drejtoria Ekonomike, po në Bashkinë Vau Dejës, (Kategorinë e pagës IV-a).

Ajo e ka konsideruar të padrejtë këtë transferim, duke pretenduar se gjatë kryerjes së këtij veprimi administrativ nuk është zbatuar procedura ligjore pasi, sektori ku ajo punonte nuk ndodhet në kushtet shkurtimit të pozicioneve të punës dhe se ekzistonin të gjitha mundësitë që ajo mund të sistemohej sërish në pozicionin e saj të mëparshëm.

Për sqarimin e pretendimit të mësipërm, nëpërmjet shkresës me nr. 231/1 prot, datë 18.03.2022 *“Kërkim dokumentacioni, lidhur me verifikimin e pretendimeve të parashtruara me kërkesën e regjistruar me nr. 231 prot, datë 16.03.2022, paraqitur nga nëpunësja *****”*, ka filluar procesi i verifikimit, në kuadër të të cilit u kërkuan aktet administrative përkatëse, nga Bashkia Vau Dejë.

Në përgjigje, me shkresën e protokolluar me nr. 1505/1/1 prot, datë 07.04.2022, është dërguar dokumentacioni i kërkuar, nga përmbajtja e të cilit rezulton e vërtetuar se, punonjësja në fjalë ka qenë nëpunëse civile e konfirmuar në pozicionin *“Specialiste Finance në Sektorin e Fuqizimit Ekonomik”* në Drejtorinë e Mbrojtjes, Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale, në Bashkinë Vau Dejës dhe ka vijuar në këtë detyrë deri në momentin e riorganizimit të këtij sektori, në kuadër të implementimit të strukturës së re të institucionit në fjalë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 387 datë 23.11.2021, *“Për miratimin e strukturës organizative organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për cdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2021”*.

Konstatohet që për implementimin e strukturës së re, është ndjekur rradha e veprimeve si më poshtë:

Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, me aktin e tij nr. 65, datë 14.12.2021, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit pranë institucionit, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, *“Për krijimin, funksionimin dhe Kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

Mbi këtë bazë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, nëpërmjet shkresës nr. 263 prot, datë 14.12.2021 *“Njoftim mbi fillimin e procedurave të ristrukturimit”*, si dhe shkresës me nr. 267 prot, datë 23.12.2021, me objekt *“Raport i Komisionit të Ristrukturimit mbi zhvillimin dhe realizimin e procedurës së ristrukturimit dhe sistemit të nëpunësve civil në administratën e Bashkisë Vau Dejë dhe Njësive Administrative në varësi, bazuar në strukturën organizative të vitit 2022”*, ka informuar personelin për fillimin e procesit të ristrukturimit të institucionit.

Komisioni i Ristrukturimit, ka vijuar punën duke analizuar e vlerësuar gjendjen që do të krijohet me strukturën e fundit dhe dokumentacionin personal të gjithë nëpunësve të bashkisë, duke përfshirë edhe atë të nëpunësës ***** , sipas rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kreut II, të Vendimit nr.125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar.

Në strukturën e fundit, Drejtoria e Mbrojtjes, Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale, është riorganizuar dhe emërtuar, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Strehimit, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, gjë e cila është shoqëruar me ndryshim e plotësim të objektivave, kompetencave dhe numrit të punonjësve.

Konkretisht, nga 10 nëpunës që kishte më parë kjo drejtori (*një drejtor dhe 9 specialistë*), u bë me 9 nëpunës (*një drejtor dhe 8 specialistë*). Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka konstatuar se pozicioni i punës "*Specialiste Finance në Sektorin e Fuqizimit Ekonomik*" në Drejtorinë e Mbrojtjes, Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale, ku ishte punësuar më parë nëpunësja ***** është suprimuar, ka bërë përpjekje për ta sistemuar atë në një pozicion tjetër, të përshtatshëm me arsimin dhe kualifikimet e saj.

Referuar përshkrimeve të punës dhe kërkesave të posaçme të pozicioneve të mbetura apo ristrukturuara, Komisioni i Ristrukturimit ka arritur në përfundimin se pozicioni "*Specialist në Sektorin e QKB*", Drejtoria Ekonomike, Kategori e pagës III-b, ishte një pozicion i përshtatshëm, i të njëjtës kategori me pozicionin e mëparshëm të mbajtur prej saj, për të cilën nëpunësja plotësonte kërkesat e veçanta, prandaj me shkresën nr. 274 prot, datë 31/12/2021, ka propozuar transferimin e saj në atë pozicion.

Mbi bazën e propozimit të mësipërm, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vau Dejës, me aktin nr. 269 prot, datë 24.12.2021, ka miratuar transferimin e nëpunëses në pozicionin "*Specialiste në Sektorin e QKB*" Drejtoria Ekonomike, në Bashkinë Vau Dejës, duke vënë në dijeni për këtë edhe nëpunësen në fjalë.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, arrihet në përfundimin se Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar dhe vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave "*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*", i ndryshuar, prandaj bazuar në pikën 1, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", ky proces hetimi administrativ duhet të përfundojë dhe çështja të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1- Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm, për shkak ristrukturimi të nëpunëses ***** , në pozicionin “*Specialiste e QKB*”, Drejtoria Ekonomike, Bashkia Vau Dejës, dhe meqënëse veprimet e Njesisë Përgjegjëse gjenden të kryera në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, çështja të arkivohet.
- 2- Të njoftohet për këtë vendim Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vau Dejës, dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha